



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Sekretari i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "ZhanD'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë \_\_\_/\_\_\_2023

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE, DHE PRANIM NË  
SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II, dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.3.2015 "Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive", i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall Procedurat e Lëvizjes Paralele dhe Pranimin në Shërbimin Civil, në pozicionin:

**1 (një) Specialist IT, i Sektorit të IT-së dhe Pritjes së Qytetarëve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Kategoria e pagës III-b)**

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË  
SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

- Afati për aplikim për lëvizje paralele është data: **27.02.2023**
- Afati për aplikim për pranim në shërbimin civil është data: **03.03.2023**

**Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin "Specialist IT" në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarit, (Kategoria III-b):**

1. Menaxhimi i sistemeve operative të bazuara në Windows si dhe mirembajtja e infrastruktures së serverave (windows server 2003, 2008, 2012 dhe 2016)
2. Administrimi i Active Directory. Failover Cluster, HyperV;

3. Konfigurimi i postës elektronike zyrtare në Microsoft Outlook në SmartPhone/Tablet, si dhe kryerjen procedurave të backup per mailbox;
4. Konfigurimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës LAN, përfshirë konfigurimet router/switch, Wifi;
5. Instalimi dhe mirëmbajtja e produkteve Microsoft Office;
6. Instalimi dhe monitorimi i Antivirusit lokalisht si dhe menaxhimin e firewallit;
7. Konfigurimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik, përfshirë kompjutera, skaner, fotokopje, ups, printer.
8. Administrimi dhe mirembajtja e rrjetit telefonik voip;
9. Menaxhimi dhe mirembajtja e rrjetit të kamerave dhe sistemit të aksesit të portave;

## I-Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha Institucionet, pjesë e shërbimit civil.

### **1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin: “Specialist IT” në Sektorin e IT-së dhe Pritjes së Qytetarit, (Kategoria III- b):**

**Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:**

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brënda së njëjtës kategori (III-b, IV-a, IV-b)
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga Institucioni).
3. Të ketë të paktën vlerësimin e fundit mirë ose shumë mire.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Profesional”, në degën Inxhinieri Elektronike. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën e kërkuar.
3. Preferohet të zotërojnë të paktën një certifikatë për sistemet operative, administrim rrjetesh, data base etj.
4. Të ketë njohuri të gjuhës angleze të vërtetuar me dëshminë përkatëse.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

### **2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijojnë:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;

4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
8. Vlerësimin e fundit në punë;
9. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
10. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 27.02.2023.**

### **3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore) brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit

### **4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista**

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin “**Specialist IT**”, do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

1. Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
3. Ligjin nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
4. Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
5. Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

6. Legjislacionin për krimin kibernetik ([www.akshi.gov.al/Legjislacioni](http://www.akshi.gov.al/Legjislacioni)).
7. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.
8. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

## **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Dokumentacionin e dorëzuar, deri në **40 pikë**.
2. Intervistën e strukturuar, **deri në 60 pikë**.

### **Vlerësimi i dokumentacionit:**

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim **është 40 pikë**.

### **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

## **6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.

## II-Pranimi në Shërbimin Civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Pranimi në Shërbimin Civil.

### 1. Kushtet dhe kriteret e veçanta për Pranim në Shërbimin Civil në pozicionin “Specialist IT” në Sektorin e IT dhe Pritjes së Qytetarëve;

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil janë:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

1. Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Profesional”, në degën Inxhinieri Elektronike. Edhe Diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat e marra në Universitetet jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara nga Institucioni përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën e kërkuar.
3. Preferohet të zotërojnë të paktën një certifikatë për sistemet operative, administrim rrjetesh, data base etj.
4. Të ketë njohuri të gjuhës angleze të vërtetuar me dëshminë përkatëse.
5. Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

### 2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes të Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

1. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
2. Jetëshkrim të plotësuar në përputhje me dokumentin tip të cilin e gjeni në link: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;

4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
5. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
6. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
7. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 03.03.2023.**

## **2. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak**

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimin të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes të Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore) brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

## **3. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët**

Kandidatët që konkurojnë për pozicionin e “**Specialist IT**” në Sektorin e IT dhe Pritjes të Qytetarit, do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

1. Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
3. Ligjin nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
4. Ligjin nr.10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
5. Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Legjislacionin për krimin kibernetik ([www.akshi.gov.al/Legjislacioni](http://www.akshi.gov.al/Legjislacioni)).
7. Rregullore për përdorimin e postës elektronike në administratën publike.
8. Legjislacioni në fuqi në lidhje me sigurinë e informacionit (<https://cesk.gov.al/legjislacioni/index.html>)

#### **4. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve**

##### **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:**

1. Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, deri në **60 pikë**.
2. Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **25 pikë**.
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **15 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultetit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

#### **6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën:

Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë